



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.40/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku me bashkëpunëtoren profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen përmbarimore të kreditorit A... Sh.P.K. me numër të regjistrimit të biznesit .... dhe seli në Pejë, Rr. ..., me pronar dhe Drejtor Menaxhues A.Ç. , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve RPHS Law me seli në Prishtinë, Rr. Major Mehmet Bushi, Hyrja 6 Nr.5, kundër debitorit NTP Supermarket “T...” me pronar F.S. dhe numër të regjistrimit të biznesit ....., me seli në Lipjan, Rr. .... p.n. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Shpëtim Sadiku me seli të zyrës në Lipjan, Rr. Gjergj Fishta p.n. për shkak të mos përmbushjes së detyrimit nga Titulli Ekzekutiv (Aktgjykimi IV.EK.nr. 536/18 datë 06.10.2021 i vërtetuar me Aktgjykimin Ae.nr.304/21 datë 24.01.2022), duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Valdrin Beka, P.nr. 472/16 datë 19.10.2016, jashtë seancës, në datën 06.09.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET PJESËRISHT I PA BAZUAR Prapësimi i Debitorit NTP Supermarket “T...” me seli në Lipjan, kundër Urdhërit Përmbarues të Përmbaruesit Privat Valdrin Beka, P.nr. 472/16 datë 19.10.2016, sa i përket:
  - a. shumave të gjykuara në procedurën kontestimore me Titullin Ekzekutiv - Aktgjykimi IV.EK.nr. 536/18 datë 06.10.2021 i vërtetuar me Aktgjykimin Ae.nr.304/21 datë 24.01.2022,
  - b. kërkesës së shpenzimeve të Debitorit të procedurës përmbarimore.
  
- II. MBETET NË FUQI Urdhëri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat Valdrin Beka, P.nr. 472/16 datë 19.10.2016, sa i përket:
  - a. përmbajtjes së Titullit Ekzekutiv - Aktgjykimit IV.EK.nr. 536/18 datë 06.10.2021 i vërtetuar me Aktgjykimin Ae.nr.304/21 datë 24.01.2022, në të gjitha pikat,
  - b. shpenzimeve të Kreditorit të shkaktuara në procedurë të përmbarimit,

ndërsa në pjesët tjera të diferencës së kërkesës së Kreditorit, i njëjti shfuqizohet.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Valdrin Beka, në territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit A... Sh.P.K, ka nxjerrë urdhër përmbareues me të cilin ka lejuar përmbarimin sipas dokumentit të besueshëm / faturave: 1. 14-210-020-267 dhe 2. 14-210-020-271, për shlyerjen e obligimit të mbetur nga këto të dyja në vlerën 16'479.48€, me kamatëvonesë 8%, përfshirë të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarimit që do të shkaktohen.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori NTP Supermarket "T..." ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhërin përmbareues për shkak të shkeljeve procedurale dhe gjendjes faktike të gabuar, duke theksuar se debitori ka përmbushur detyrimin e tij ndaj kreditorit përmes pagesave në para të gatshme. I njëjti ka propozuar që lidhur me këtë të dëgjohen dëshmitarë të rastit.

Kreditori i çështjes në kundërshtimin e prapësimit të paraqitur gjykatës ka theksuar se duke u bazuar në furnizimet me material që i ka bërë debitorit, ky i fundit mbetet akoma në borxh ndaj kreditorit për shumën 15'159.48€.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, si gjykatë e çështjes ka mbajtur seancë dëgjimore në datat 25.05.2018 dhe 28.06.2018, pas të cilave e njëjta me Konkluzionin PPP.nr.44/2017 ka udhëzuar Kreditorin A... Sh.P.K. që të iniciojë procedurën kontestimore kundër Debitorit NTP Supermarket "T..." në afat prej 15 ditësh, dhe realizimin e kredisë në çështje përmbareimore e ka shtyrë deri në momentin e përfundimit të procedurës kontestimore.

Pala Kreditore e ka njoftuar gjykatën e lartë përmendur për inicimin e procedurës kontestimore, përmes parashtrësës së datës 03.10.2018. Më tej, në datën 04.04.2022 Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar kërkesë për ndërmarrje të veprimeve lidhur me rastin PPP.nr.44/2017 meqë çështja kontestimore është përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë - Aktgjykimi IV.EK.nr. 536/18 datë 06.10.2021, i cili sipas mjetit juridik të ushtruar është vërtetuar me Aktgjykimin Ae.nr.304/21 datë 24.01.2022. Kërkesës në fjalë, Kreditori i ka bashkëngjitur kopjet e noterizuara të titujve ekzekutive, të cilat përmbajnë edhe vulën e ekzekutueshmërisë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Gjyqtari i çështjes, ka filluar m administrimin e lëndëve nga data 15.08.2022.

Në rastin konkret, gjykata ka vlerësuar pretendimet e palëve në këtë kontest si dhe shkresat përcjellëse të çështjes; Gjegjësisht, gjykata ka vlerësuar ecurinë dhe zhvillimin e çështjes si dhe përfundimin e procedurës kontestimore të palëve ndërgjyqëse, me çka konstatoi se dokumenti mbi bazën e të cilave duhet vazhduar procedura e përmbarimit, është Titulli Ekzekutiv Aktgjykimi IV.EK.nr. 536/18 datë 06.10.2021 i vërtetuar me Aktgjykimin Ae.nr.304/21 datë 24.01.2022, i cili dokument i përshtatshëm për ekzekutim, konform dispozitës së nenit 22 par 1.1 nenit 24 par.1 dhe nenit 27 të Ligjit për procedurën përmbareimore.

Sipas vendimit gjyqësor të përmendur, Debitori NTP Supermarket "T..." i detyrohet Kreditorit A... Sh.P.K. me shumën 15'159.48€ me kamatë vonesë 8%, duke e llogaritur atë nga data e parashtrimit të padisë 28.09.2019 e deri në përmbushjen përfundimtare, duke ia njohur edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme 2'500.80€. Nga këto, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që vërejti se inicimi i procedurës përmbarimore me propozim ishte bërë fillimisht për një vlerë / kërkesë më të lartë të hollash, konkretisht ishte iniciuar për vlerën 16'479.48€, me kamatëvonesë 8%, përfshirë të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarimit që do të shkaktohen. Deri në përfundimin e kësaj çështjeje, Gjykata caktoi kufinj të përmbarimit sipas Titullit ekzekutiv ndërkaq për diferencën e kërkesës së Kreditorit përtej Titullit Ekzekutiv e shfuqizoi Urdhërin Përmbarimor si në pikën II. të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e shkaktuara në procedurën e përmbarimit, gjykata vendosi t'ia njohë ato kreditorit, si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, meqë pasuan nga mosekzekutimi i borxhit me kohë nga ana e debitorit, konform neni 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore lidhur me neni 452.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe në bazë të Rregullores për Tarifa të Odës së Avokatëve të Kosovës, të cilat do të kalkulohen nga Përmbaruesi i çështjes me rastin e përfundimit të procedurës së ekzekutimit.

Prandaj nga sa tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi në bazë të nenit 73 të Ligjit për procedurën e përmbarimit.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.40/2022, dt.06.09.2022

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.